

Hapet thirrja për bursa për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus +, në Universitetin Andrei Saguna din Constanta, në Rumani

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Andrei Saguna din Constanta, në Rumani, për semestrin e parë të vitit akademik 2017-2018.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie në fushën e Administrim Biznesit.

Kohëzagjatja e bursave:

- Stafi Akademik (7 ditë).

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë).

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim **për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze ose rumune në nivelin B2 në varësi të programit të mësimdhënies);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.doc

**Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyntë gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikime: 23 Qershor 2017

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!